



**Titulli i projektit**

Mbështetja e sektorit të artizanatit në ZF Lezhë

**Tipi i projektit**

Zhvillim ekonomik

**Vendndodhja e projektit**

ZF Lezhë/Zadrimë, Balldren

**Buxheti i paravlerësuar**

50,000 Euro

**Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve**


Familjet e zonës së Zadrimës dhe të rrethit të Lezhës kanë një traditë të gjatë në prodhimin e produkteve të artizanatit dhe dekorimit për përdorim vetjak, por edhe për tregtim. Megjithatë, me kalimin e kohës, tradita e dikurshme e prodhimit të veshjeve, qilimave, tekstileve të ndryshme, apo drurit po fillon të vanitet, pasi nuk ka mekanizma për të kaluar natatin nga një brez te tjetri. Mbështetja e sektorit të artizanatit ka potencialin për të rritur të ardhurat; për të promovuar turizmin kulturor dhe për rritjen e punësimit.

**Qëllimi/et specifik të projektit**

Objekivi kryesor i projektit është rigjallërimi i sektorit të artizanatit dhe krijimi i mundësive të reja për punësim dhe mbështetje të turizmit.

**Rezultatet e pritshme dhe treguesit**

Projekti mund të ketë përfitues direktë në 3-5 njësi të zonës së Lezhës. Numri i përfituesve direktë përcaktohet në varësi të madhësisë dhe llojit të ndërhyrjes. Si fillim këshillohet të fillohet trajnimi dhe promovimi i produkteve të artizanatit me një grup të rinjsh prej 30-50 vetësh. Mundësitë janë më të kufizuara në fillim të projektit, duke pasur parasysh edhe nevojën për të gjetur mjeshtra artizanë me përvojë dhe të përkushtuar. Zhvillimi i sektorit të artizanatit mund të japë përfitime indirekte, duke shtuar larminë e produktit turistik të zonës përtej diellit/rërës dhe turizmit kulturor/fetar.



## Aktivitetet e projektit

Projekti mund të zgjasë për 6 muaj deri në 1 vit.

Aktivitetet përfshijnë:

- Identifikimi i dizenjove autentike nga rethi i Lezhës, me qëllim që të promovohen asetet kulturore të zonës;
- Trajnim formal dhe praktik i 30-50 të rinjve në artizanat (kryesisht tekstile). Trajnimin duhet të përmbajë edhe elemente të marketingut dhe aftësive të të bërit biznes;
- Mbështetja e të rinjve të trajnuar për krijimin e një shoqate/biznesi social; hartimin e një biznes-plani dhe për sigurimin e pajisjeve dhe dhe lëndës së parë fillestare për fillimin e punës. Mbështetja mund të shoqërohet edhe me asistencë për marketimin, nëpërmjet krijimit të aksesit dhe lidhjeve me tregun (p.sh.: katalog i prodhimeve; hotelet kryesore, etj..)

## Maturimi i projektit

Nuk ka projekt të gatshëm. Planifikimi dhe zbatimi i aktiviteteve është relativisht i lehtë dhe nuk kërkon përgatitje të mëdha paraprake. Parakusht për fillimin e projektit është identifikimi dhe përzgjedhja nga aktorët lokalë i mjeshtrave artizanë, të cilët e ushtrojnë aktivitetin edhe në ditët e sotme.

## Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Financues potencialë të projektit janë bashkia, buxheti i shtetit përmes skemave ndihmuese të punësimit dhe vetëpunësimit (SHKP); donatorë.

Bashkia dhe/ose Këshilli i Qarkut duhet të kenë autorësinë e projektit, pa të cilin qëndrueshmëria e projektit mbetet e dobët. Përfshirja e aktorëve nga sektori privat (në segmente të tjera të zinxhirit të vlerës) mund të krijojë potenciale për efekt multiplikator të ndërhyrjes.

## Kostot e projektit

1. Identifikimi i produkteve tipike të artizanatit dhe i mjeshtrave artizanë – 10,000 Euro
2. (Opsionale) Design/përshtatja e produkteve tipike me tendencat e kohës – modernizimi dhe marketimi i produkteve – 30,000 Euro
3. Trajnimi i 50 të rinjve për një periudhë 6-mujore – 15,000 Euro
4. Krijimi i biznesit social dhe mbështetja për biznesin e ri (start-up) – 25,000 Euro